



Viti i VI-të i Botimit, Nr.2,
Dhjetor 2015

MARRËDHËNIA MES IZOLIMIT NË INSTITUCIONET E VUAJTJES SË DËNIMIT DHE SHFAQJES SË PROBLEMEVE MENDORE

Krisalda Sauli

Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, “Albanian University”, Tiranë

Adresë kontakti krisaldasauli@gmail.com

“Nuk është veprimi si i tillë, por reagimet ndaj tij, ato që e bëjnë atë devijant”

Houard Beker

Përmbledhje

Objektivat: Ky studim ndërmerret me qëllim që të eksplorohej më nga afër gjendja psikologjike e të dënuarve që janë duke vuajtur dënimin në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Republikën e Shqipërisë. Fokusi është pikërisht mbi faktorët që nxisin zhvillimin e problematikave psikologjike tek personat që u është hequr liria dhe detyrohen të jetojnë të izoluar nga shoqëria.

Metodologjia: Për të realizuar këtë studim jemi fokusuar në mbledhjen e të dhënave duke u ndalur në studimet më të fundit mbi problematikën psikologjike që vijnë nga izolimi i individit. Për këtë studim jemi bazuar në shfletimin e bibliografisë shkencore brenda dhe jashtë vendit, nga ku kemi mbledhur të dhëna mjaft të vlefshme përmes librave, artikujve shkencorë dhe statistikave të burgjeve.

Rezultatet: Nga analiza e burimeve materiale që kishim në dispozicion rezultoi se izolimi është një faktor i rëndësishëm në shfaqjen e një gjendje të rënduar psiko-emocionale si tek individët e shëndetshëm mendërisht dhe tek kategoria e personave që kanë vuajtur edhe më parë nga probleme psikologjike apo psikiatrike.

Përfundimet: Është e rëndësishme që të kemi në konsideratë që izolimi nxit tek të dënuarit zhvillimin e një sërë problemesh psikologjike që i shkaktojnë personit vuajtje dhe stres. Këto problematika psikologjike janë të nevojshme të njihen nga punonjësit e burgjeve, në mënyrë që të dinë si të ndërhyjnë dhe të japin ndihmën në rast krizash dhe të lehtësojnë procesin e përshtatjes së të dënuarit me mjedisin e tij të ri.

Fjalë çelës: *Stres psikologjik, probleme të shëndetit mendor, burg, izolim.*

THE RELATIONSHIP BETWEEN THE ISOLATION IN PRISONS AND THE PROMOTION OF PSYCHOLOGICAL PROBLEMS

Abstract:

Objective: the purpose of this study is to explore more closely the psychological condition of prisoners who are serving the isolation inside prisons in Albania. The focus is squarely on the factors that promote the development of psychological problems among people deprived of liberty, and are forced to live isolated from society.

Methodology: To realize this study we focused on data collection on the most recent studies on the psychological problems that come from the isolation to prisoners. For this study we are based on scientific bibliography, from where we gathered valuable information through books, scientific articles and prison statistics.

Results: The analysis of material resources we had available showed that isolation is an important factor in the emergence of a grave condition psycho-emotional as mentally healthy humans and in the category of people who have previously suffered from psychological problems or psychiatric.

Conclusions: It is important to bear in mind that isolating prisoners boosts to the development of a range of psychological problems that cause a person suffering and stress. These psychological issues are required to be recognized by prison staff in order to know how to intervene and provide assistance in case of an emergency and to facilitate the process of adaptation of the convicts with his new state.

Key words: *Psychological Stress, Mental Health Problems, Prison, Isolation.*

Hyrje

Të pranishme në realitetin tonë të përditshëm janë krimet e kryera nga autorë të ndryshëm të cilëve caktohet nga ligji e nga gjykata një dënim alternativ. Krimi padyshim është një ndër problemet më të mëdha sociale, po krimi nuk është thjesht një ndodhi, një shifër që tregon se sa janë të larguar nga jeta apo sa dëme kanë ndodhur, nuk është thjesht një procesverbal që nënshkruhet për të mbyllur çështjen, por krimi kushtëzon jetë, le gjurmë të dhimbshme jo vetëm te viktimat e te familjarët e viktimës por dhe te vetë autori. Shpesh një formë sjellje në burg është izolimi i të burgosurve. Ata të cilët nuk binden, nuk arrijnë të përshtaten me mjedisin e institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale vendosen në dhoma izolimi, në kushte ekstreme të distancuar nga njerëzit, larg zhurmës e bisedave, larg dallimit të ditës nga nata dhe të detyruar të qëndrojnë në botën e mendimeve të tyre. Mendohet se po të izolohet do të detyrohet të përshtatet, për të mos qëndruar sërish në atë botë të errët mendimesh, por harrohet që edhe pse ata të burgosur kanë kryer krime ata vazhdojnë të mbeten njerëz dhe vazhdojnë të mbartin një biografi të jetës së tyre. Neglizhenca e këtij fakti bën që të shtohet te të burgosurit në izolim dhe një tjetër barrierë, ajo e çrregullimeve nervore, në disa njerëz në nivel më të ulët në disa të tjerë në nivele ekstreme. Veçanërisht neurozat janë shumë të shpeshta për të gjitha kategoritë e të burgosurve, por dhe psikozat e bëjnë shumë të ndjeshme praninë e tyre. Ndjenja e fajit, stigma e kriminelit, dhe izolimi janë komponent të një ngarkese supreme emocionale, shpesh një peshë e papërbalueshme që drejton një numër të lartë të burgosurish në çrregullime të rënda mendore që jo vetëm i kufizojnë jetën por e drejtojnë në veprime të pakthyeshme, shpërthyes qoftë dhe brenda mjedisit të burgut. Të punosh me të burgosurit, të kontribuosh që individët që vuajnë dënimin në këto institucione pasi t'i rikthehet liria të jenë pjesë produktive dhe e nevojshme e shoqërisë, t'i riintegroh duke i trajtuar si genie njerëzore, së pari kërkon aftësi, njohuri dhe një profesionalizëm serioz, dinjitoz e empatik.

Mbi çështjen e izolimit kanë mbajtur qëndrim shumë studiues dhe janë kryer studime që e vërtetojnë nivelin e dëmit që shkaktohet në psikikën e njeriut. Por, realisht në vendit tonë nuk është kryer ende një studim i mirëfilltë mbi këtë çështje. Në kuadër të realizimit të këtij prezantimi, janë mbledhur të dhëna nga studime

brenda dhe jashtë vendit të cilat raportojnë efektet negative mbi shëndetin mendor për shkak të heqjes së lirisë dhe izolimit në burgje.

Metodologjia

Ky është një studim i llojit cilësor bazuar në studimin e literaturës dhe i materialit tjetër dokumentar dhe grumbullimi i materialit kontekstual. Për këtë studim jemi bazuar në shfletimin e bibliografisë shkencore brenda dhe jashtë vendit, nga ku kemi mbledhur të dhëna mjaft të vlefshme përmes librave, artikujve shkencorë, revistave. Përdorimi i kësaj metodologjie është konsideruar eficient për të përballuar gjerësinë e opinioneve, eksperiencave, të praktikave dhe të besimeve mbi izolimin e të burgosurve e problemeve të shëndetit mendor që ata shfaqin.

Rezultatet

1. Ndikimi i izolimit në shëndetin mendor të të burgosurve

Burgimi përkufizohet si izolim nga jeta sociale, shkëputje nga aktivitete të dëshiruara me qëllim ndëshkimit e autorit për aktin e kryer. Mbajtjen e tij në një institucion të strukturuar, në mungesë të hapësirave për përsëritje të aktit dhe me synim uljen e shkallës së rrezikshmërisë për shoqërinë (1;6).

Izolimi në vetvete është një proces që synon rehabilitimin e të dënuarit nëpërmjet ndryshimit të stilit të jetesës së tij. Kushtet që duhet të përshtatet i dënuari, si: ngritja në mëngjes, konsumimi i vakteve, takimet me familjaret në orare të caktuara krijojnë te i burgosuri një ndjenjë ankthi, nervozizmi, gjendje jo të mirë fizike si këputje, përgjumje, ëndrra të frikshme, shqetësime në stomak, në disa raste frikë dhe panik (7). Studime të bashkëkohësve dhe studime të mëvonshme rezultojnë se veçanërisht ditët e para personi që është duke vuajtur dënimin shfaq gjendje të ndryshme emocionale, të cilat konstatohen lehtësisht prej psikologut. Mund të përmenden se ka të theksuara ndjenjat e turpit e e fajit, shpesh ndihet i pasigurt e i pashpresë për të ardhmen e tij, përlojtje e vazhdueshme që shpreh dëshpërimin për veten por edhe pendimin për veprën e ndërmarrë, në disa raste mund të shfaqen irritime emocionale të papritura nga rritja e nivelit të ankthit dhe frikës si dhe sjellje agresive ndaj vetes apo të tjerëve për shkak të mungesës së pavarësisë. I dënuari përballet me gjendje psikologjike të rënda me në bazë ankthin për shkak të aktivizimit të shumë mekanizmave mbrojtëse të cilat pengojnë adaptimin, përshtatjen me ambientin e komunitetin e burgut dhe mund ta drejtojnë në konsum psikologjik ose në shfaqje të çrregullimeve mendore. Mjedisi i burgut dhe izolimi i plotë ka një efekt të fuqishëm për trupin dhe mendjen dhe është dukshëm iniciuesi për shfaqjen e problemeve mendore dhe kryesisht halucinacioneve, ose siç u quajt nga filozofi Nitsche dhe psikologu Williams në fillim të shukullit të kaluar izolimi është nxitësi i “psikozës së burgut”(3).

Në institucionet e vuajtjes së dënimit të burgosurve mund t’u kërkohet që t’u bëhet ndonjë lloj këshillimi, qoftë si pjesë e vlerësimit në vazhdim të procedurave të rehabilitimit, qoftë për t’i ndihmuar për të përballuar kërkesat e jetës së burgut. Por, problematik mbetet fakti se të burgosurit tentojnë të minimalizojnë reagimet e tyre duke mohuar çdo problem të shëndetit të tyre mendor (1;5;12). Prej të burgosurve në izolim një përqindje relativisht e ulët shfaqin simptomat ndërkohë që pjesa më e madhe përzgjedhin të qëndrojnë të heshtur e të distancuar. Vetëm kur problemi është i pakontrollueshëm prej tyre reagojnë. Simptomat e shfaqura te të burgosur të ndryshëm janë kronike ose akute. Për shkak të këtij qëndrimi simptomat përkeqësohen dhe gjendja e tyre rëndohet ndjeshëm, gjë që i drejton në veprime të pakontrolluara e simptoma të çrregullimeve të rënda psikopatogjike. Është konstatuar se çrregullimet bëhen të dukshme në një periudhë kohore prej gjashtë muajsh (8). Truri ka funksione pafund. Ndaj edhe pse të burgosurit mundohen të mos shfaqin çrregullimet e pranishme ato janë të pashmangshme për t’u bërë pjesë e pandashme e realitetit aktual të tyre.

Psikiatër dhe psikologë qartësojnë se burgu është një ambient stresues për një individ të fortë psikologjikisht,

e aq më tepër për të sëmurët mendorë. Në këtë institucion realisht nuk ka një strukturë të organizuar mirë të shërbimeve komunitare, ndaj dhe kjo kategori krijon shumë probleme (2). Në burgje konstatohet një nivel i lartë çrregullimesh psikopatologjike për shkak të izolimit, sjelljeve brutale, kushteve johigjenike, ngarkesës emocionale. Më të shpeshta janë çrregullimet e ankthit, e depresionit bipolar, deluzive, të personalitetit dhe skizofrenia (1). Psikologë të shumtë janë interesuar për të studiuar gjurmët që të izolimi te një qenie njerëzore dhe të gjitha studimet me të burgosur të cilët kanë qëndruar në izolim për më tepër se dhjetë ditë demonstrojnë efekte të rënda në shëndetin mendor të tyre (1;6) dhe dëshmojnë se praktika e izolimit mbart një rrezikshmëri të konsiderueshme për të dënuarit (12). Si fillim raportohen ndryshime në perceptim, mungesë afeksioni, vështirësi në të menduar, arsyetuar, humbje periodike të kujtesës, probleme kinestizike, si dhe humbje të shpejtë në peshë dhe probleme kardiovaskulare (12). Më pas simptomat përkeqësohen. Të shpeshta janë rastet me klaustrofobi, tërbim, halucinacione, shkëputje nga realiteti dhe apati (11). Në disa raste mund të shfaqen nervozizëm, të folurit me vete, deluzione, inat irracional, dhimbje të forta koke, probleme me gjumin (12). Një ndër simptomat më të hasura të një përqindje e lartë të të burgosurve në izolim është vështirësia e tyre për të diferencuar realitetin nga mendimet, ose krijimi i një realiteti të dhimbshëm brenda imagjinatës së tyre. Të burgosurit gjithashtu përjetojnë një ndjeshmëri të madhe ndaj zhurmave dhe aromave (1). Studime gjithashtu vërtetojnë se halucinacionet janë një simptomë e përbashkët për shumicën e të burgosurve në izolim. Më të shpeshta raportohen halucinacionet vizuale të cilat mund të përfshijnë të parit insekte që ndodhen kudo në dhomë madje dhe në trupin e tyre, dhe auditive që përfshijnë zhurma të forta e të çuditshme(9).

Raportimet e shekullit të 19-të tregojnë një numër të konsiderueshëm të burgosurish në izolim të cilët tentojnë akte agresioni ndaj vetes, prerje të gjymtyrëve si dhe suicide. Diagnozat e hershme të çrregullimeve të personalitetit dhe të problemeve të rënda psikopatologjike konsiston në qëndrimin gjatë në izolim. Fenomen shumë problematik dhe shqetësues mbeten aktet homicide dhe suicide të cilat vlerësohen si më të përhapura në ambientet e burgut sesa në popullsinë e një vendi në tërësi (1;10). Hulumtime të mëvonshme kanë arritur të paraqesin disa probleme psikopatologjike që janë më shpesh të hasura në burgje (1;8;9;12), si: çrregullimi i atakut të panikut, depresioni madhor, depresioni psikotik, çrregullim bipolar, çrregullimet e personalitetit paranoid, çrregullimi deluzional (9) dhe skizofrenia.

2. Grupet më të predispozuara ndaj sëmundjeve mendore

Në institucionet e vuajtjes së dënimit numri më i madh i të dënuarve është e përbërë nga meshkuj prej të cilëve përqindja më e madhe vuan nga çrregullimet e personalitetit dhe depresionit madhor. Kanë një përqindje shumë herë më të lartë në çrregullimin e personalitetit antisocial, nga psikozat si dhe nga depresioni në krahasim me popullsinë civile (6;11).

Te gratë evidentohet një përqindje më e ulët e çrregullimeve mendore në krahasim me burrat, pasi numri i grave të dënuara dhe të paraburgosura është shumë herë më i vogël se i burrave. Megjithatë, është konstatuar, duke mbledhur të dhëna nga burgjet, se një numër i konsiderueshëm i të burgosurve femra janë të reja në moshë dhe të bardha (8). Kryesisht, femrat janë më të predispozuara për t'u prekur nga çrregullime kufitare të personalitetit histrionik si dhe çrregullimet e humorit, dhe janë të pranishme shpesh dhe halucinacionet kryesisht ato auditive (3;14).

Shqetësim përbëjnë minorenët të cilët përbëjnë kontigjentin më të riskuar në krijimin e predispozitave për zhvillimin e çrregullimeve psikopatologjike. Evidentohen një sërë simptomash të çrregullimeve të sjelljes delinkuente (4). Gjithashtu, një përqindje e lartë e tyre vuajnë edhe nga çrregullimet psikotike si pasojë e varësisë ndaj substancave narkotike apo çrregullimeve impulsive të kontrollit, si dhe prapambetje mendore (14).

Por dhe moshë e tretë e të burgosurve me burgim të përjetshëm janë kontigjente të burgosurish që më shpesh shfaqin çrregullime të ankthit të shoqëruara me melankoli si dhe çrregullime të ndryshme të personalitetit, kryesisht atij antisocial, histrionik, kufitar, varës, obsesiv-kompulsiv, si pasojë e izolimit edhe çrregullime të tilla si demenca Alzheimer apo demenca senile të cilat sjellin degradime të theksuar psikike dhe vështirësi

në përballimin e vuajtjes së dënimit (14).

3. *Faktorët* që ndikojnë në shfaqjen e sjelljeve kriminale nga individi

Predispozita më e madhe për t'u izoluar është për të burgosurit që mbartin çrregullime psikotike, çrregullime të personalitetit kryesisht atij antisocial ose janë abuzues ndaj substancave narkotike (1). Njerëz të cilët vuajnë jo vetëm humbjen e një kohe të gjatë në burg por vuajnë dhe përballjen e vazhdueshme me gjykesin më të fuqishëm, veten. Pyetja më v rastare, më shkatërruese, më mbytëse e më retorike e jetes së tyre është pyetja: pse? Është pikërisht kjo pyetje që rrit rrezikun për shfaqjen e problemeve të shëndetit mendor e që mund të lidhet me të paktën katër tipare dinamike që ndikojnë në formimin e personalitetit, ku secili tipar mbart kundërshtime të fuqishme për të ndryshuar dhe domosdoshmërisht me kërkesa për metoda specifike trajtimi (9;12;14).

Së pari, janë disavantazhet ekonomiko-sociale. Varfëria eksteme, emigrimi, divorcet dhe privimi i shërbimeve adekuate edukuese të tilla si shkollimi, punësimi i qëndrueshëm, kanë penguar zhvillimin e aftësive të tyre sociale si dhe kanë favorizuar zhvillimin e çrregullimeve mendore dhe shkeljeve ligjore.

Së dyti, dinamika familjare dhe marrëdhëniet disfunktionale. Pothuajse tek të gjithë pacientët me probleme të shëndetit mendor, vihet re një disfunktionim në marrëdhëniet interpersonale sidomos kur kjo lidhet me anëtarët e familjes. Neglizhenca, keqtrajtimet, induktimi i një modeli sjelljeje keqpërshtatëse dhe përforcuese në kohë, mungesa e modeleve referuese të përshtatshme si dhe ekzistenca e një klime konstante konfliktuale kanë ndikuar në kryerjen e krimeve të rënda, madje dhe brenda familjes.

Së treti, predispozita gjenetike. Është konstatuar në bazë të të dhënave të kartelave se një pjesë e të sëmurëve mendorë kanë të paktën një nga anëtarët e familjes me probleme psikopatologjike. Bashkëdominca në zhvillim i mjedisit dhe i aspekteve biologjike bën të mundur shfaqjen e problemeve psikopatologjike që qëndronin të fshehura brenda individit.

Së katërti, ngjarjet traumatike. Shfaqja e simptomave psikopatologjike krijohen në situata traumatike si rrjedhojë e ndjenjës së fajit karshi kryerjes së veprës penale, përjetimit traumatik të situatës së arrestimit ose periudhës së arratisjes, ndaj marrëdhënieve konfliktuale me bashkëvuajtësit e tjerë që mund të çojnë edhe në rrezikimin e jetës si dhe ndaj rasteve jo të rralla ku mund të kenë qënë pre e abuzimit seksual.

4. *Aftësitë individuale që duhet të zotërojnë punonjësit e burgut*

Vetëm në dekadën e parë të këtij shekulli është hedhur një dritë më e fortë mbi çështjen e izolimit të burgosurve dhe shfaqjes së problemeve psikopatologjike. Tashmë po strukturohen metoda për të trajtuar në mënyrë më frytëdhënëse këtë kategori, për një riintegrim të sukseshëm dhe për një shoqëri me më pak probleme. (4,11) Mënyra më efikase për të reduktuar numrin e lartë të krimeve të kryera nga ish të burgosurit është nëpërmjet ndërhyrjeve dhe shërbimeve të cilat duhet të jenë të bazuara në një "mendim të përbashkët" dhe planifikim nga disa departamente qeveritare për të siguruar një metodë të koordinuar. Nuk është e mundur që vetëm një grupim njerëzish të arrijnë të ndryshojnë një sjellje shumëvjeçare, por ai grupim nëse unifikohet e qartëson rezultatet që do të arrihen mund të bindë padyshim masën e t'i ndikojë aq sa për të ndryshuar dhe ajo qëndrim. (4) Synimi i burgimit është që këta individë jo vetëm të ndëshkohen por edhe të rehabilitohen e të riintegrohen në një shoqëri funksionale. Shumë të dënuar hyjnë në burg me shumë probleme kronike sociale dhe personale (shpesh të lidhura me arsytet e kryerjes së veprave penale), të cilat shumë rrallë mund të zgjidhen gjatë kohës që kalojnë në burg. Brenda në këtë institucion ata mund të humbasin punën ose shtëpinë, marrëdhëniet e tyre mund të prishen dhe mund të ndikohen nga sjellje negative e të burgosurve të tjerë (6;11). Gama e problemeve personale të lartpërmendura ka shumë mundësi të mos zgjidhen gjatë qëndrimit në burg, madje dhe mund të përkëqsohen. Psikologu i burgut luan një rol kyç në vlerësimin e të burgosurve të rinj dhe ka funksion edhe si këshilltar për të burgosurit dhe për personelin e burgut. Të dënuarit mund të shfaqin probleme mendore për herë të parë në mjedisin e burgut

ose mund t'i ketë zotëruar që më parë (13). Trajtimi i tyre kërkon kushte adekuate, çka vështirësohet në kushtet e privimit të lirisë.

Puna me autorë të veprave penale që vuajnë nga sëmundje mendore, kërkon zhvillimin e dijeve dhe aftësive të shumta. Jo gjithsecili mund të punojë me këtë kategori, dhe jo gjithsecili ka afeksion e sukses në profesionet në lidhje me të burgosurit. Ndaj duhet medoemos të ketë një punonjës në institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale që t'i përmbahet disa preokupimeve (4):

1. **Njohuritë:** punonjësi i shërbimit të provës duhet të jetë i familjarizuar me legjislacionin përkatës, me procedurat e shërbimit dhe rolin e specialistëve të ndryshëm që mund të përfshihen.
2. **Trajnimi profesional:** është e domosdoshme për punonjësit e shërbimit të provës që të marrin pjesë në sesione trajnimi për trajtimin e kësaj kategorie të dënuarish.
3. **Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërdisiplinar:** puna me autorë të veprave penale me sëmundje mendore, kërkon gjithmonë një përfaqje ndërinstitucionale. Duhet të kuptohen qartë rolet, përgjegjësitë, detyrat e çdo institucioni ose eksperti.
4. **Siguria:** punonjësit e shërbimit të provës duhet të kenë njohuri të rregullave bazë lidhur me sigurinë personale dhe duhet të mbështeten në ndihmën e kolegëve të tjerë.
5. **Trajtimi human:** punonjësit e shërbimit të provës duhet t'i trajtojnë në mënyrë humane personat e sëmurë që kanë kryer vepra penale dhe duhet të jenë në gjendje të njohin ndikimin e diskriminimit në shëndetin mendor dhe karakteristikat e diskriminimit që mund t'u bëhet personave të cilët kanë ose supozohet se kanë probleme të shëndetit mendor.

Është e pamundur të arrihet që të gjithë punonjësit pranë burgjeve të jenë zotëruar të të gjitha këtyre aftësive në mënyrë perfekte. Problematika më e madhe ndërlidhet me reformat institucionale dhe me faktin se personat me çrregullime të rënda të shëndetit mendor që kanë kryer një vepër penale dhe janë dënuar nga gjykata të vuajnë dënimin në institucione psikiatrike, mbahen në burgje, vend i cili nuk posedon infrastrukturën e duhur dhe resurset njerëzore të trajnuara, të specializuara për trajtimin specifik që e ka të nevojshëm ky kontingjent që mund të jetë “mjekim i detyruar” ose “mjekim i përkohshëm i detyruar” (5). Trajtimi i të burgosurve që vuajnë nga probleme psikike mbetet ende një sfidë mbarëbotërore e fuqishme por jo e paarrirë. Edhe në vendin tonë në koherencë me thellimin e reformave të infrastrukturës social-ekonomike, mjekësore dhe asaj ligjore, janë arritur zhvillime inkurajuese mjaft pozitive të përmiresimit të gjëndjes së institucioneve të paraburgimit dhe të vuajtjes së dënimit. Megjithatë, ende nuk mund të themi se kemi arritur standarde bashkëkohore në trajtimin më dinjitoz dhe profesional të këtyre pacientëve, drejt një rehabilitimi psikiatrik, psikologjik dhe social sa më shkencor (14).

Diskutime

Ky studim u fokusua në identifikimin e problemeve mendore si pasojë e izolimit në burgjet e Shqipërisë, me qëllim që të shihet lidhja mes faktorëve që nxisin shfaqjen e simptomatologjisë, apo të sjelljeve të pakoncentruara brenda ambienteve të burgut. Në bazë të të dhënave konstatohet lidhja korrelacionale mes shfaqjes së çrregullimeve mendore për shkak të qëndrimit në izolim për një kohë me tepër se dhjetë ditë. U konkludua se ambienti i burgut ka një efekt negativ për çdo individ pavarësisht çdo lloj tipari të personalitetit të tij, e pasojat që mund të sjellë raportohen të jenë të pashmangshme, e në disa raste të parikuperueshme. Mendohet se gjinia ndikon në shfaqjen e problemeve mendore më serioze. Meshkujt kanë tendencën që të mos shfaqin simptoma herët në krahasim me grupet e tjerë dhe pse ata janë më të shumtë në numër. Duke krahasuar studimet e kryera në fund të shekullit të kaluar me studimet e viteve të fundit, u konstatua se shqetësuese mbetet problematika e sjelljeve suicidale si dhe atyre homocidale. Element të tjerë të cilët mendohet të kenë ndonjë lloj lidhje me shfaqjen e problemeve mendore që u morrën në shqyrtim është mungesa e theksuar e preokupimeve të punonjësit të burgut, si dhe neglizhenca shtetërore përkundrejt të

dënuarve. Për realizimin e këtij studimi u mor në shqyrtim literaturë nga brenda dhe jashtë vendit, dhe u vu re se as faktori kohë e as faktori vendndodhje nuk ka korrelacion me ndryshimin e situatës në burgje. Si në Shqipëri sot dhe vite më parë, ashtu dhe nëpër botë problemet mendore, në disa raste, marrin alertin përmes izolimit për tu shfaqur, ndërkohë që në raste të tjera instaurohen në atë mjedis.

Përfundime

Izolimi ndikon fuqishëm në shëndetin mendor të të burgosurve. Popullsia në burgje shfaq nivelin më të lartë të çrregullimeve psikopatologjike në krahasim me popullsinë në tërësi. Pra, të burgosurit në izolim jo vetëm që nuk rehabilitohen apo binden, por stimulohen në këtë mënyrë për të qënë dhe më problematikë për veten dhe për të tjerët. Për të reduktuar numrin e kriminelëve me probleme të rënda mendore për shkak të qëndrimit gjatë në izolim dhe për të parandaluar përsëritjen e veprimeve të dhunshme e akteve të rënda penale është shumë e rëndësishme të merren në konsideratë nevojat e një pjesë e kërkesave të të dënuarëve, të përcaktohen shërbimet ekuivalente e trajtimet specifike për secilën nga kategoritë e të burgosurve, dhe kryesisht duhet të synohet që e ardhmja e ish të burgosurve të jetë më e strukturuar në mungesë të terrenit predispozues për përsëritjen e akteve të së shkuarës. Shoqëria, shteti, punonjësit e burgut duhet të zotërojnë mirë njohuri, dije, aftësi por shumë më tepër ndjeshmëri dhe empati për të punuar me të sëmurët mendorë në burgje dhe për rehabilitimin dhe unifikimin e ish të dënuarëve me popullsinë në tërësi.

Referenca

1. Carr, Alan; McNultyTorrey, EF Muireann; Journal of the American Academy of Psychiatry and the Law, 2008, "Clinical Psychology 2010", The Insanity Offense, New York: W.W. Norton, 36, 179-183; 75-79.
2. Shtino, Nazim; Lala, H. Sadik, 2011, "Psikiatria Ligjiore", "ALBTIPOGRAFIA", Tiranë, 120-103; 79-80.
3. World Health Organisation, 1978 "Health, which is a state of complete physical, mental and social wellbeing, and not merely the absence of disease or infirmity, is a fundamental human right ...", Alma-Ata Declaration, 125-130.
4. Leskoviku, M, Nieuwerkerk, van I., Deering, J., et al., 2009; "Manual për punonjësin e shërbimit të provës", "SHTYPSHKRONJA", Tiranë, 212-214, 221-223.
5. Drejtoria e përgjithshme e burgjeve, analiza 2013, 7, www.dpbsh.gov.al
6. All-Party Parliamentary Group on Prison Health (report), "THE MENTAL HEALTH PROBLEM in UK HM Prisons", 2005, House of Commons London, 3-7.
7. Amidi, I., Zuberi, M., 2002, "Being in prison-right or wrong", Macedoni, 1-2.
8. Doris, J., James and Lauren E. Glaze (BJS Statisticians), 2006, "Mental Health Problems of Prison and Jail Inmates", UK, 2.
9. National Institute of Health Research, 2010 "The pathway of prisoners with mental health problems through prison health services and the effect of the prison environment on the mental health of prisoners", Offender Health Research Network, University of Manchester, 48-50.
10. <http://psycosynthesis.blogspot.gr/2009/09/blog-post.html>, akses me: 01.02.2015
11. <http://tlife.gr/Article?family-sumperifora/0-12-19353.html>, akses me: 27.01.2015
12. Haney Craig, 2001, "The Psychological Impact of Incarceration: Implications for Post-Prison Adjustment", University of California, Santa Cruz, 8-11.
13. Pettijohn F.Terry, 1996, "Psikologjia, një hyrje koncize", "LILO", Tiranë, 269-272.
14. Myslimaj, Fatbardha, Meksi, Andia, 2010, "Trajtimi i të burgosurve me probleme të shëndetit mendor në Institucionet e Ekzekutimit të Penale në Shqipëri", Tiranë, 5-6.